

## **Të reja rreth vaksinës së COVID-19 nga Johnson & Johnson/Janssen**

Vaksina e COVID-19 nga Johnson & Johnson/Janssen është e disponueshme në NYC për personat e moshës 18 vjeç e lart, pas një ndërprerjeje të shkurtër për të hetuar një problem të mundshëm shëndetësor të lidhur me vaksinën. Departamenti i Shëndetit dhe i Higjienës Mendore të NYC (Departamenti i Shëndetit të NYC) vazhdon të ketë besim në sigurinë dhe efektivitetin e vaksinës Johnson & Johnson dhe vaksinave të tjera të autorizuara të COVID-19. Vaksinimi mbetet hapi më i rëndësishëm që mund të ndërmerrni për të mbrojtur veten, personat tuaj të dashur dhe komunitetet tona nga COVID-19.

### **Pse pati ndërprerje të përdorimit të vaksinës Johnson & Johnson?**

Në 13 prill 2021, Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (Centers for Disease Control and Prevention, CDC) dhe Administrata e Ushqimeve dhe Barnave (Food and Drug Administration, FDA) rekomandoi ndalimin e përkohshëm të vaksinës Johnson & Johnson pas raportimeve të një mpiksjeje të rrallë të gjakut te gjashtë persona që morën këtë vaksinë. Rastet u identifikuan nga sistemi i monitorimit të sigurisë së vaksinave të CDC-së dhe FDA-së. Përdorimi i vaksinës u ndërpre, në mënyrë që të mund të mblidheshin dhe të shqyrtoheshin më shumë informacione.

### **Çfarë tregoi hetimi?**

Nga data 21 prill 2021, pati 15 raste me një lloj mpiksjeje të rrallë të gjakut me numër të ulët të pllakëzave të gjakut nga rreth 8 milion persona që kanë marrë vaksinën Johnson & Johnson, që prej autorizimit të saj. Ky fenomen quhet trombozë (mpiksje gjaku) me sindromën e trombocitopeninë (numër i ulët i pllakëzave të gjakut) (thrombosis with thrombocytopenia syndrome, TTS). Të gjitha rastet e raportuara me TTS ishin femra ndërmjet moshës 18 dhe 59 vjeç, me simptoma që filluar gjashtë deri në 15 ditë pas vaksinimit. Ky është një raport prej rreth shtatë rastesh me TTS për një milion femra ndërmjet moshës 18 dhe 49 vjeç, të cilat janë vaksinuar dhe më pak se një rast për një milion femra të moshës 50 vjeç e lart, të cilat janë vaksinuar. Në provat klinike të vaksinës, u konstatua edhe një rast me TTS te një subjekt mashkull.

### **Çfarë rekomandon CDC dhe FDA për përdorimin e vaksinës?**

CDC dhe FDA rekomandojnë që vaksina Johnson & Johnson të vazhdojë t'u jepet personave 18 vjeç e lart. Ky vendim bazohet në rekomandimin e Komitetit Këshillues rreth Praktikave të Imunizimit, një grup i pavarur ekspertësh të shëndetit mjekësor dhe publik, të cilët shqyrtuan të dhënat dhe informacionin e disponueshëm dhe llogaritën rrezikun e mundshme të shëndetit pas marrjes së vaksinës, krahasuar me përfitimet e saj. Personat që marrin vaksinën, veçanërisht femrat nën 50 vjeç duhet të jenë të vetëdijshme rreth rrezikut të rrallë por në rritje të TTS-së dhe se disponohen opsione të tjera të vaksinës së COVID-19, në të cilat nuk është konstatuar ky rrezik.

### **Pse po e përdor NYC vaksinën edhe pas problemit të sigurisë?**

Rreziku i TTS-së është shumë i ulët dhe vaksina është shumë efektive në parandalimin e sëmundjeve të rënda, shtrimit në spital dhe vdekjes për shkak të COVID-19. Tani që e njohim rrezikun, mund t'u japim personave që marrin vaksinën Johnson & Johnson informacionin që ju nevojitet për të identifikuar simptomat e mundshme të TTS-së dhe të marrin ndihmë mjekësore të menjëhershme. Edhe ofruesit e kujdesit shëndetësor janë tashmë në dijeni të rrezikut, që do të thotë se mund të diagnostikojnë dhe të trajtojnë pacientët që zhvillojnë TTS pas marrjes së vaksinës Johnson & Johnson. Asnjë mjekim, terapi ose vaksinë nuk është 100% e parrezikshme.

### **Nëse zgjedh të marr vaksinën Johnson & Johnson, a ka ndonjë masë kujdesi shtesë që duhet të ndërmerret?**

Ndërkohë që rreziku i TTS nga vaksina Johnson & Johnson është shumë i ulët, duhet ta monitoroni veten për simptoma të mundshme për tre javë pas marrjes së vaksinës, të tilla si:

- Mungesë frymëmarrjeje
- Dhimbje gjoksi
- Ënjtje të këmbëve
- Dhimbje të gjata të barkut
- Dhimbje të forta ose të gjata të kokës
- Shikim të turbullt
- Mavijosje të shpejtë
- Njolla të vogla të kuqe poshtë lëkurës, përtej zonës së injektimit

Nëse keni ndonjë nga këto simptoma brenda tre javësh pas vaksinimit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore — shkoni në një spital pranë jush ose telefononi në numrin **911**. Tregojini ofruesit të kujdesit shëndetësor që ju trajton që keni marrë vaksinën Johnson & Johnson.

Përndryshe, efektet anësore të zakonshme pas vaksinimit përfshijnë dhimbje dhe ënjtje të krahut ku morët vaksinën, lodhje, dhimbje të lehta, ethe, dhimbje koke të lehta ose pak temperaturë. Këto janë efekte anësore të pritshme dhe zakonisht fillojnë brenda tre ditëve të para pas vaksinimit (më të zakonshme ditën pas vaksinimit) dhe zgjasin zakonisht një deri në dy ditë pasi fillojnë.

### **A ka rrezik të TTS-së nga vaksinat e tjera të COVID-19?**

TTS nuk është lidhur me vaksinat e COVID-19 nga Pfizer-BioNTech dhe Moderna pas administrimit të më shumë se 200 milion dozave të administruara në SHBA. Ne i nxisim personat që nuk duan të marrin vaksinën Johnson & Johnson që të marrin në konsideratë një prej këtyre vaksinave.

Disponohen qindra qendra vaksinimi përreth NYC. Vizitoni faqen [vaccinefinder.nyc.gov](https://vaccinefinder.nyc.gov) për të gjetur një qendër vaksinimi (listohen vaksinat që jepen në secilën qendër) ose telefononi në numrin 877-829-4692 për ndihmë rreth caktimit të një orari në një qendër që menaxhohet nga bashkia. Shumë qendra pranojnë edhe hyrje të lirë. Shikoni [këtu](#) për listën e qendrave me hyrje të lirë që menaxhohen nga bashkia.

**Si ta dimë që nuk ka probleme të tjera sigurie me vaksinën?**

Vaksinat e COVID-19 vazhdojnë të jenë nën monitorim intensiv të sigurisë nga CDC, FDA dhe grupe të tjera. Identifikimi i numrit të vogël të rasteve me TTS nga miliona doza vaksinash që janë dhënë në të gjithë SHBA-në dhe ndërprerja e përdorimit të vaksinës Johnson & Johnson tregojnë që sistemet e sigurisë funksionojnë dhe që siguria dhe transparencja janë prioritete kryesore. Ne jemi të përkushtuar që të ndajmë me ju informacione rreth vaksinave, duke përfshirë çdo problem të mundshëm sigurie.

**Ku mund të marr më shumë informacion?**

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi telefonojini ofruesit të kujdesit shëndetësor ose numrit **311**. Për informacion rreth vaksinës së COVID-19 dhe burimet, vizitoni faqen [nyc.gov/covidvaccine](https://nyc.gov/covidvaccine). Fleta e fakteve rreth pacientëve të vaksinës Johnson & Johnson, e rishikuar nga FDA mund të gjendet [këtu](#). Informacion shtesë disponohet në faqen e internetit të CDC-së [këtu](#).

**Departamenti i Shëndetit i NYC mund t'i ndryshojë rekomandimet sipas zhvillimit të situatës. 4.29.21**